

VENDIM
Nr. 176, datë 29.8.2024

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ACHELO” SHPK NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “KOTORRI”**

(Ndryshuar me vendimin nr. 281, datë 6.11.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a”, dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a” dhe 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.8.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1534/14 prot., datë 27.8.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Achelo’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Kotorri’”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Achelo” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1534 prot., datë 20.6.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Kotorri” me kapacitet prodhues 1.9 mw, me vendndodhje në pjesën fundore të përroit të Seltës, degë e lumit të Holtës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 131, datë 2.7.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Achelo” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 3.7.2024 dhe 4.7.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 12.7.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën me nr. 1534/4 prot., datë 5.7.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe zhvillimin e një seance dëgjimore për plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria mori pjesë në seancën dëgjimore dhe në vijim të kësaj seance, me shkresën me nr. 1534/5 prot., datë 18.7.2024, ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit, pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni u konstatua se mbetej ende dokumentacion i pa plotësuar për këtë aplikim, i cili iu evidentua shoqërisë me *email*-in e protokolluar me nr. 1534/6 prot., datë 23.7.2024. Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1534/7 prot., datë 25.7.2024 ka depozituar dokumentacionin përkatës i cili gjendet në pjesët respektive të relacionit.

- Me vendimin nr. 156, datë 31.7.2024, Bordi i ERE-s vendosi të zgjasë afatin e vendimmarrjes për aplikimin e shoqërisë “Achelo” sh.p.k., me qëllim nevojën për zhvillimin e korrespondencës së mëtejshme me shoqërinë për të sqaruar informacionin/dokumentacionin që ka mbetur ende për t’u plotësuar dhe depozitim të tij në vijim në ERE.

- Me shkresën nr. 1534/10 prot., datë 2.8.2024 dhe *email*-in e protokolluar në vijim në ERE me nr. 1534/12 prot., datë 20.8.2024, ERE ka kërkuar plotësimin e dokumentacionit i cili konsistonte në saktësimin, në kuadër të mbështetjes financiare, si dhe dokumentacionin, në lidhje me fillimin

e punimeve. Shoqëria, me shkresat nr. 1534/11 prot., datë 15.8.2024 dhe nr. 1534/13 prot., datë 26.8.2024 ka depozituar dokumentacionin respektiv.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Kontrata për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Kotorri”, me kapacitet prodhues 1.9 mw, me nr. 376 rep., nr. 123 kol., datë 8.3.2023, ka një afat 49-vjeçar dhe nga përllogaritja e afateve, duke filluar nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate rezulton se shoqëria ka humbur afërsisht 1 vit e 5 muaj dhe periudha e mbetur për licencim është 47 vjet e 7 muaj, por ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nuk mund të japë një licencë me afat më të madh se 30 vjet për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Si e tillë, vlerësohet që shoqëria të licencohet për një afat 30-vjeçar, afat i cili do të fillojë nga data e parashikuar për fillimin e operimit, pra jo më vonë se data 4.8.2025.

- Aktualisht, shoqëria disponon një leje të vlefshme për përdorimin e burimit ujqor, por ajo nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit, ndaj, ashtu si në rastet analoge, do t’i lihet kusht shoqërisë që të depozitojë në ERE lejen e rinovuar brenda afatit të fundit të vlefshmërisë së saj, pra brenda datës 15.11.2027. Gjithashtu, ashtu sikurse në rastet pararendëse, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që, në rast se nuk depoziton lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor brenda këtij afati dhe ka një urdhër për ndërprerjen/pezullimin e veprimtarisë nga inspektoratet/agjencitë e mbrojtjes së territorit/ mjedisit, atëherë ajo nuk ka të drejtë të operojë/ushtrojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “Achelo” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat “a”, “b” dhe “c”; dhe pikën 2.1, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Achelo” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kotorri”, me kapacitet të instaluar 1.9mw, për një afat 30-vjeçar.

2. Shfuqizuar.

3. Shoqëria “Achelo” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor brenda datës 16.11.2027.

4. Në rast se shoqëria nuk depoziton lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 dhe ka një vendim për ndërprerjen/pezullimin e veprimtarisë nga inspektoratet/

agjencitë e mbrojtjes së territorit/mjedisit, atëherë ajo nuk ka të drejtë të operojë/ushtrojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti